



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V

Sesioni pranveror

Kuvendi i Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe të nenit 44 të Rregullores së Kuvendit, në seancat plenare të mbajtura më 10 janar dhe 10 mars 2017, pas debatit të zhvilluar në lidhje me ndalimin e kryetarit të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, me propozim të GP të AAK-së dhe me harmonizim të grupeve parlamentare: PDK, LDK, LVV dhe Nisma, miraton këtë:

R E Z O L U T Ë

Lidhur me ndalimin e ish-kryeministrit të Kosovës, z. Ramush Haradinaj, në Francë

1. Lirimi pa kushte i ish-kryeministrit të Kosovës, z. Ramush Haradinaj, të ndodhë sa më shpejt dhe të konsiderohet detyrë primare shtetërore.
2. Të pezullohet procesi i dialogut për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë deri në lirimin e ish-kryeministrit të Kosovës, z. Ramush Haradinaj.
3. Qeveria e Republikës së Kosovës të kërkojë nga BE-ja që ta detyrojë Serbinë për t'i anuluar të gjitha aktakuzat dhe fletarrestet e lëshuara nga Serbia nëpërmjet Interpolit për shtetasit e Republikës së Kosovës.
4. Qeveria dhe institucionet tjera të Republikës së Kosovës obligohen t'i ndërmarrin të gjitha veprimet e nevojshme në mënyrë që t'i informojnë të gjitha instancat ndërkombëtare se "...e refuzojnë juridiksionin universal të Serbisë për krimet e pretenduara në tërë territorin e ish-Jugosllavisë", dhe konform kësaj të kërkojnë lirimin e ish-kryeministrit të Kosovës dhe kryetarit të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, z. Ramush Haradinaj.

Nr. 05-R-011

Prishtinë, më 10 mars 2017

Kryetari i Kuvendit
Kadri VESELI

Kopja e Rezolutës u dërgohet:

- Qeverisë së Republikës së Kosovës,
- Arkivit të Kuvendit.